



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

RAPORT ME REKOMANDIM

I

AVOKATIT TË POPULLIT

Ankesa nr. 314/2019

kundër

Komunës së Fushë Kosovës

lidhur me kufizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike

Drejtuar: Z. Burim Berisha, kryetar
Komuna e Fushë Kosovës

Prishtinë, më 17 qershor 2020

Qëllimi i raportit

1. Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes së Komunës së Fushë Kosovës lidhur me ankesën e A. G. (ankuesja) për qasje në dokumente publike dhe tek detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve përkatëse që burojnë nga Ligji nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP)

Baza kushtetuese dhe ligjore

2. Sipas nenit 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.*”
3. Gjithashtu edhe sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, me përgjegjësitë e përcaktuara me nenin 18, paragrafët 1, 2, 4, 5, 6 dhe 8.

Me dërgimin e këtij raporti tek institucionet përgjegjëse, Avokati i Popullit synon që t'i kryejë këto përgjegjësi kushtetuese dhe ligjore.

Përshkrimi i çështjes

Faktet, dëshmitë dhe informatat të cilat i posedon Institucioni i Avokatit të Popullit, të ofruara nga ankuesi dhe të mbledhura nga hetimi i bërë, përmbledhen si në vijim:

4. Më 26 korrik 2018, kishte paraqitur kërkesë për informacion/qasje në dokumente zyrtare në: *Regjistrin e pronës së luajtshme dhe të paluajtshme që komuna e ka në shfrytëzim dhe posedim; Planin Urbanistik të komunës së Fushë Kosovës; Projektin për asfaltimin e rrugës “Pajazit Islami”, në Nakaradë.*
5. Më 16 nëntor 2018, ankuesja kishte paraqitur kërkesë për informacion/qasje në dokumente zyrtare në dokumentacionin e *Projektit të zhvilluar me organizatën Caritas prej vitit 2016-2018, respektivisht listën e të punësuarve nëpërmjet projektit, kontratat e të punësuarve, kualifikimin dhe buxhetin e ndarë nga komuna për këtë organizatë.; Listën me emrat e mësimitdhënësve të punësuar në Sh.M.U. “Mihail Grameno” dhe listën e pagave të mësimitdhënësve.*
6. Më 5 dhjetor 2018, kishte paraqitur kërkesë për informacion/qasje në dokumente zyrtare në *Listën me numrin dhe emrat e çerdheve private të licencuara që veprojnë në Fushë Kosovë dhe numrin e fëmijëve të regjistruar nëpër të gjitha çerdhet private, si dhe në ato publike.*
7. Më 22 tetor 2018, ankuesja kishte marrë një përgjigje, përmes së cilës është njoftuar se harta e Planit Urbanistik është e punuar në programin ArchiCaD dhe ftohet në zyrat e Drejtorisë për Planifikim Urban për ta realizuar qasjen. Mirëpo dokumenti në të cilin është ofruar qasja nuk është dokumenti i kërkuar nga ankuesja.
8. Më 12 nëntor 2018, ankuesja kishte marrë përgjigje nga zëdhënësi për informim në Komunën e Fushë Kosovës, me të cilën e njoftojnë se *Projekti për asfaltimin e rrugës “Pajazit Islami”, në Nakaradë është në procedura të nënshkrimit të kontratës.* Ndërsa, për kërkesën për qasje në *Regjistrin e pronës së luajtshme dhe të paluajtshme që komuna e ka në shfrytëzim dhe posedim*, njoftojnë për pamundësinë e ofrimit të qasjes për të gjitha pronat dhe kërkojnë që kërkesa të specifikohet.

9. Më 29 mars 2019, zëdhënësi për informim në Komunën e Fushë Kosovës, nëpërmjet postës elektronike, i kishte përcjellë ankueses Planin Zhvillimor Urban, e që në fakt nuk ishte dokumenti në të cilin ankuesja ka kërkuar qasje.
10. Më 19 nëntor 2018, ankuesja e kishte përsëritur kërkesën dhe e kishte njoftuar zëdhënësin për informim në Komunën e Fushë Kosovës se ajo nuk kishte marrë përgjigje në kërkesat e parashtruara.
11. Ndërsa në kërkesat e parashtruara më 16 nëntor 2018 dhe më 5 dhjetor 2018, ankuesja nuk kishte marrë përgjigje.
12. Më 5 prill 2019, bazuar në nenin 10 të LQDP-së, ankuesja kishte parashtruar ankesë te Avokati i Popullit kundër Komunës së Fushë Kosovës për kufizim të së drejtës për qasje në dokumente publike.
13. Më 25 prill 2019, Avokati i Popullit iu kishte drejtuar me shkresë kryetarit të komunës së Fushë Kosovës, nëpërmjet të cilës kishte kërkuar informata për veprimet që ishin ndërmarrë apo që planifikoheshin të ndërmerreshin përkitazi me kërkesat e ankueses për qasje në dokumente publike.
14. Më 15 dhe më 16 maj 2019, Institucioni i Avokatit të Popullit kishte komunikuar me zëdhënësin për informim, me ç' rast ia kishte përcjellë edhe një herë kërkesat e ankueses për qasje në dokumente publike.
15. Më 17 maj 2019, Komuna e Fushë Kosovës e kishte përcjellë te Institucioni i Avokatit të Popullit një përgjigje përmes së cilës e kishte njoftuar me përgjigjet që ata ia kishin kthyer ankueses.
16. Më 21 maj 2019, përfaqësuesja e Institucionit të Avokatit të Popullit e kishte njoftuar zëdhënësin për informim në Komunën e Fushë Kosovës se në përgjigjet të cilat i kishin marrë bëhet fjalë vetëm për tri nga 6 kërkesat që ankuesja i kishte paraqitur në Komunën e Fushë Kosovës. Për më tepër, përgjigjet e dhëna janë të paplota.
17. Më 29 korrik 2019, Avokati i Popullit iu kishte drejtuar me shkresë kryetarit të komunës së Fushë Kosovës, nëpërmjet së cilës kishte kërkuar informata për veprimet që ishin ndërmarrë, por nuk kishte marrë përgjigje.
18. Më 24 tetor 2019, ankuesja e kishte njoftuar Institucionin e Avokatit të Popullit se ishte realizuar qasja në kërkesën e datës 26 korrik 2018, për qasje në *Planin Urbanistik të komunës së Fushë Kosovës*, por jo edhe në kërkesat e tjera.

Instrumentet ligjore të zbatueshme në Kosovë

19. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), në nenin 41, paragrafi 1, parasheh të drejtën për qasje në dokumente publike, sipas të cilit definohet: *“Secili person gëzon të drejtën e qasjes në dokumente publike.”*
20. Paragrafi 2 i po të njëjtit nen të Kushtetutës përcakton se dokumentet e mbajtura nga të gjitha institucionet janë të qasshme për të gjithë, me përjashtim të atyre dokumenteve qasja në të cilat është e kufizuar me ligj: *“Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë.”*

21. E drejta për t'u informuar është e drejtë e garantuar me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, neni 19 i së cilës përcakton: *“Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacionit dhe ideve me çfarëdo mjetesh, pa marrë parasysh kufijtë.”*
22. Lirinë për të marrë dhe për të dhënë informacion e parasheh edhe neni 10, paragrafi 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) - [Liria e Shprehjes]: *“Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë...”*
23. Fryma e nenit 41 të Kushtetutës është përcjellë edhe në nenin 1 të LQDP-së, sipas të cilit: *“Ky ligj garanton të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje, pas kërkesës, në dokumentet e mbajtura, hartuara apo pranuar nga institucionet publike.”*
24. Ligji nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke proklamuar parimin e administratës së hapur, në nenin 9, paragrafi 1, parasheh: *“Organet publike duhet të veprojnë me transparencë.”*

Analiza e rastit

25. Avokati i Popullit vëren se kërkesat për qasje në dokumente publike të ankueses, drejtuar Komunës së Fushë Kosovës, kanë të bëjnë me dokumente që duhet të jenë dokumente të qasshme përmes publikimit proaktiv nga Komuna e Fushë Kosovës, në pajtim me legjislacionin në fuqi. Po ashtu, disa nga dokumentet e kërkuara kanë të bëjnë me aktivitete të prokurimit të cilat nuk mund të gjenden në faqen e E-prokurimit, siç janë: plani i menaxhimit të kontratës, pagesat, duke përfshirë urdhër blerjet, faturat e operatorit ekonomik, raportet e menaxherit të kontratës, raporti përfundimtar i pranimit etj., e që janë dokumente që prodhohen nga administrata e komunës.
26. Avokati i Popullit tërheq vëmendjen tek praktika e GjEDNJ-së që, sipas nenit 53 të Kushtetutës, paraqet bazë për interpretimin e të drejtave të njeriut të garantuara me Kushtetutë. GjEDNJ-ja, në aktgjykimin për rastin *Observer and Guardian v. The United Kingdom*, thekson: *“T'i mohosh publikut informacione mbi funksionimin e organeve të shtetit, do të thotë të shkelësh të drejtën themelore të demokracisë.”*¹
27. Më tej GjEDNJ-ja, në rastin *Stell and Morris v. The United Kingdom*, i datës 15 maj 2005, ndër të tjera, e konsideron se në një shoqëri demokratike edhe grupet e vogla dhe ato joformale duhet të jenë në gjendje t'i kryejnë aktivitetet e tyre në mënyrë efektive dhe se ekziston një interes i fortë publik që ua mundëson grupeve dhe individëve të jashtëm që të kontribuojnë në debatin publik, duke dhënë informacione me interes të përgjithshëm (paragrafi 89).²
28. Duke i pasur parasysh obligimet ligjore, përgjegjësitë dhe kompetencat që komunitat i kanë sipas dispozitave ligjore në fuqi, Avokati i Popullit tërheq vëmendjen edhe tek Udhëzimi Administrativ (MAPL) nr. 01/2015 për Transparencë në Komuna, me të cilin rregullohet

¹ Case of *Observer And Guardian V. The United Kingdom*, (Application no. [13585/88](#), 26 November 1991)

² Rasti *Stell and Morris v The United Kingdom*, (Aplikimi nr. 68416/01, 15 maj 2005).

promovimi dhe avancimi i transparencës së organeve të komunës dhe i administratës komunale në informimin e qytetarëve dhe të grupeve të tjera të interesit. Po ashtu, ky udhëzim administrativ i obligon organet e komunës që ndaj qytetarëve dhe ndaj palëve të interesuara t'i bëjnë transparente dhe të qasshme aktivitetet e komunës dhe të garantohet qasja në dokumente publike për personat fizikë dhe juridik (neni 9).


29. Avokati i Popullit vlerëson se përjashtimet e së drejtës për qasje në dokumente janë të përcaktuara në nenin 17 të LQDP-së. Ndërsa informacionet mund të kufizohen vetëm për qëllime të mbrojtjes së interesave legjitime publike, të jetës ose të interesave të tjera legjitime private, të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe me Ligjin për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë.
30. Avokati i Popullit konstaton se në rastin e ankueses, Komuna e Fushë Kosovës ka dështuar në përmbushjen e detyrimeve lidhur me mundësimin, përkatësisht lejimin për qasje në dokumente publike në përputhje me kërkesën e parashtruar të ankueses, e cila e drejtë është e garantuar me akte vendore si dhe me instrumente ndërkombëtare.
31. Po ashtu, Avokati i Popullit konsideron se Komuna e Fushë Kosovës duhet të bëjë më shumë në ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve të saj në raport me trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike dhe në zbatim të LQDP-së.
32. Avokati i Popullit thekson se interesi i publikut për mënyrën e shfrytëzimit të parasë publike dhe për llogaridhënien është thelbësor në drejtim të promovimit dhe të forcimit të demokracisë dhe të qeverisjes së mirë. Rol të rëndësishëm në këtë aspekt kanë qytetarët, shoqëria civile dhe mediat.
33. Nisur nga sa u tha më lart dhe me qëllim të respektimit të së drejtës për qasje në dokumente publike, si e drejtë kushtetuese dhe ligjore, si dhe rritjes së transparencës dhe të llogaridhënies, e në mënyrë që qytetarët ta shfrytëzojnë këtë të drejtë, si mjet të fuqishëm për kontrollin e punës së organeve të pushtetit, Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Komunës së Fushë Kosovës

- *Ta trajtojë kërkesën e ankueses, t'i përgjigjet asaj dhe t'i ofrojë qasje në dokumentet e kërkuara, në pajtim me Ligjin nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike dhe në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj") dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit ("Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, (...) duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë"), ju lutemi të na informoni për veprimet që do t'i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Hilmi Jashari
Avokat i Popullit